

**VENDIM**  
**Nr. 27, datë 20.5.2016**

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 28, DATË 1.7.2013, “PËR LICENCIM SHA  
UJËSJELLËS-KANALIZIME TIRANË”**

Në mbështetje të nenit 14, pika 1/a, nenit 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, si dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 958, datë 6.5.2009, “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë”, Komisioni Kombëtar Rregullator

**VENDOSI:**

Në vendimin nr. 28, datë 1.7.2013, “Për licencim sh.a. Ujësjellës-Kanalizime Tiranë” bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 1 bëhet ndryshimi si më poshtë:

Drejtues ligjor: Redi Molla.

Drejtues teknik: Ortjon Dhami.

Drejtues teknik: Edgar Cani.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**  
**Ndriçim Shani**